

VENDIM
Nr. 3, datë 14.1.2013

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK PËR SHA UK BERAT KUÇOVË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996 “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, si dhe metodologjisë mbi vendosjen e tarifave, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së

VENDOSI:

1. Të miratohet për sh.a. UK Berat-Kuçovë, tarifat si më poshtë:

a) Për shërbimin e furnizimit me ujë

	Tarifa fikse lekë/muaj/klient	Tarife volumetrike lekë/m³
- Konsumator familjar (me dhe pa matës)	100	42;
- Institucione buxhetore	200	120;
- Ente private	200	120;
b) Për shërbimin e largimit të ujërave të ndotura		
- Konsumator familjar	-	10;
- Institucione buxhetore	-	18;
- Ente private	-	20.

2. Objektivat e treguesve të performancës të shoqërisë për vitin 2013:

- uji pa të ardhura (humbjet)	70%;
- niveli i matjes	60%;
- kohëzgjatja e furnizimit	12 orë/ditë;
- eficaenca e energjisë	2,8 kwh/m ³ ;
- efikasiteti i stafit	5 staf/000 lidhje;
- mbulimi me ujë	90%;
- mbulimi me kanalizime	80%;
- norma e arkëtimit	85%;
- cilësia e ujit (klor+koliiform)	100% norma e sigurisë.

3. Pagesa rregullatore për sh.a. UK Berat-Kuçovë do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

4. Ky vendim hyn në fuqi më 1.1.2013 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi